

LIGJ
Nr. 93/2022

PËR DEKORATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i llojeve të dekoratave, që jepen në Republikën e Shqipërisë, si dhe i rregullave, procedurave dhe kritereve për propozimin, shqyrtimin e dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse dhe mbajtjen e tyre publike.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin dhe organizimin e sistemit të dekoratave në Republikën e Shqipërisë, që jepen si shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi ndaj shtetasve shqiptarë apo të huaj për kontributin e dhënë dhe meritat e shquara apo të veçanta, civile ose ushtarake, ndaj shtetit dhe kombit shqiptar

Neni 3
Parime të përgjithshme

1. Dhënia e dekoratave në Republikën e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:
 - a) parimi i mirënjohjes publike;
 - b) parimi i vlerësimit të kontributit;
 - c) parimi i meritokracisë;
 - ç) parimi i objektivitetit;
 - d) parimi i përgjegjshmërisë dhe transparencës;
 - dh) parimi i proporcionalitetit;
 - e) parimi i barazisë gjinore; dhe
 - ë) parimi i reciprocitetit ndërkombëtar.
2. Përfitimi i një dekorate në Republikën e Shqipërisë nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohet si e tillë në rrugë individuale ose institucionale.
3. Dhënia e dekoratës nuk shoqërohet me shpërblim financiar.

KREU II SISTEMI I DEKORATAVE

Neni 4 **Subjektet përfituese**

Dekoratat që parashikohen në këtë ligj mund t'i jepen çdo shtetasi, shqiptar ose të huaj, personi juridik, privat ose publik, forcës, shërbimit ose njësisë ushtarake, si dhe shërbimeve ose njësisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. Nuk mund të jetë anëtar i urdhrave të parashikuar në këtë ligj personi i cili ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit.

Neni 5 **Llojet e dekoratave**

Dekoratat në Republikën e Shqipërisë ndahen në urdhra dhe medalje, si më poshtë:

- a) Urdhri Suprem i Shqipërisë;
- b) Urdhri i Skënderbeut;
- c) Urdhri i Lisit Akademik;
- ç) Medalja e Meritës Ushtarake;
- d) Medalja e Meritës Civile;
- dh) Medalja “Nënë Tereza”;
- e) Medalja “Pishtar i Demokracisë”;
- ë) Medalja e Mirënjohjes Publike;
- f) Medaljet përkujtimore ushtarake dhe civile;
- g) Medalja e Shërbimit Ushtarak;
- gj) Medalja e Shërbimit të Rendit Publik.

Neni 6 **Autoritetet përgjegjëse për dhënien e dekoratave**

1. Dekoratat e parashikuara në shkronjën “a” deri në shkronjën “e” të nenit 5 të këtij ligji jepen me dekret të Presidentit të Republikës. Dekreti i Presidentit botohet në Fletoren Zyrtare.

2. Dekoratat e parashikuara në shkronjën “ë” të nenit 5 të këtij ligji jepen me urdhër të Kryeministrit.

3. Dekoratat e parashikuara në shkronjën “f” të nenit 5 të këtij ligji jepen me urdhër të Kryeministrit ose të ministrit propozues për krijimin e dekoratës.

4. Dekorata e parashikuar në shkronjën “g” të nenit 5 të këtij ligji jepet me urdhër të ministrit përgjegjës për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Dekorata e parashikuar në shkronjën “gj” të nenit 5 të këtij ligji jepet me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 7 **Urdhri Suprem i Shqipërisë**

1. Urdhri Suprem i Shqipërisë është dekorata më e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe shprehja më e lartë e mirënjohjes së shtetit shqiptar, e cila jepet për kontribute dhe merita të veçanta, të shquara e të qëndrueshme, civile ose ushtarake, në dobi të shtetit dhe kombit shqiptar, si edhe të shoqërisë dhe të vlerave demokratike.

2. Urdhri Suprem i Shqipërisë përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

- a) Gjerdani i Madh i Urdhrit;
- b) Ylli i Madh;

- c) Oficer i Madh;
- ç) Komandar;
- d) Oficer;
- dh) Kalorës.

3. Urdhri Suprem i Shqiponjës përbëhet nga të gjithë të dekoruarit e urdhrorit në një nga shkallët e tij. Presidenti i Republikës është kryetar i urdhrorit.

4. Shkalla “Gjerdani i Madh i Urdhrit” mbahet vetëm nga Presidenti i Republikës në detyrë dhe i kalohet presidentit pasardhës gjatë ceremonisë së fillimit të detyrës të Presidentit të Republikës, sipas rregullave të caktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë.

5. Presidenti i Republikës është mbajtës i shkallës “Ylli i Madh” që nga dita e marrjes së detyrës.

6. Shkalla “Ylli i Madh” mund t’i jepet edhe kreut të shtetit, kryetarit të parlamentit ose kryeministrit të një shteti të huaj gjatë vizitave zyrtare mbi bazën e zakoneve dhe traditës diplomatike, si dhe të reciprocitetit ndërkombëtar. Shkallët e tjera të “Urdhrit Suprem të Shqiponjës” mund t’i jepen shtetasit të huaj për shkak të funksionit mbi bazën e zakoneve dhe traditës diplomatike, si dhe të reciprocitetit ndërkombëtar.

7. Mbajtësit e shkallës “Ylli i Madh” dhe “Oficer i Madh i Urdhrit Suprem të Shqiponjës” janë pjesë e radhës së përparësisë në aktivitetet ceremoniale, sipas rregullave të përcaktuara në ceremonialin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

8. Mbajtësit e shkallës “Ylli i Madh” shoqërohen pas vdekjes me ceremoni zyrtare dhe nderime ushtarake.

Neni 8

Urdhri i Skënderbeut

1. Urdhri i Skënderbeut jepet për të vlerësuar kontribute dhe merita të dalluara e të qëndrueshme, civile ose ushtarake, në dobi të shtetit e kombit shqiptar, si dhe të shoqërisë e vlerave demokratike.

2. Urdhri i Skënderbeut përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

- a) Ylli i Madh;
- b) Oficer i Madh;
- c) Komandar;
- ç) Oficer;
- d) Kalorës.

3. Urdhri i Skënderbeut përbëhet nga të gjithë të dekoruarit e urdhrorit në një nga shkallët e tij. Presidenti i Republikës është kryetar i urdhrorit.

4. Presidenti i Republikës është mbajtës i shkallës “Ylli i Madh” që nga dita e marrjes së detyrës. Shkalla “Ylli i Madh” i jepet për shkak të funksionit, pas mbarimit të tij edhe Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit, kur kanë ushtruar funksionin për jo më pak se 2 (dy) vjet.

5. Mbajtësit e shkallës “Ylli i Madh” dhe “Oficer i Madh i Urdhrit të Skënderbeut” janë pjesë e radhës së përparësisë në aktivitetet ceremoniale, sipas rregullave të përcaktuara në ceremonialin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

6. Mbajtësit e shkallës “Ylli i Madh” shoqërohen pas vdekjes me ceremoni zyrtare dhe nderime ushtarake.

Neni 9

Urdhri i Lisit Akademik

1. Urdhri i Lisit Akademik jepet për merita dhe kontribute të veçanta në fushat e artit, kulturës, dijes, shkencës, arsimit, sportit, gazetarisë, si dhe në zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe vlerave demokratike.

2. Urdhri i Lisit Akademik përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

- a) Ylli i Madh;
- b) Komandar;
- c) Kalorës.

3. Urdhri i Lisit Akademik përbëhet nga të gjithë të dekoruarit e urdhrit në një nga shkallët e tij. Presidenti i Republikës është kryetar i urdhrit.

4. Mbajtësit e shkallës “Ylli i Madh i Urdhrit të Lisit Akademik” janë pjesë e radhës së përparësisë në aktivitetet ceremoniale sipas rregullave të përcaktuara në ceremonialin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Medalja e Meritës Ushtarake

1. Medalja e Meritës Ushtarake u jepet subjekteve që janë pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për aktet e vetëmohimit e sakrificës, trimërisë dhe guximit gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, në kohë paqeje ose lufte.

2. Në raste të veçanta kjo medalje u jepet edhe subjekteve të tjera për akte të kryera prej tyre në funksion të mbrojtjes së tërësisë territoriale të Republikës.

3. Medalja e Meritës Ushtarake mund t’u jepet edhe ushtarakëve të huaj, nëse kanë kryer, për aktet e vetëmohimit e sakrificës, trimërisë dhe guximit për llogari të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Medalja e Meritës Ushtarake përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

- a) Medalja e Artë e Meritës Ushtarake;
- b) Medalja e Argjendtë e Meritës Ushtarake;
- c) Medalja e Bronztë e Meritës Ushtarake.

5. Medalja e Meritës Ushtarake mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën shkallë.

6. Mbajtësit e shkallës së Medaljes së Artë të Meritës Ushtarake janë pjesë e radhës së përparësisë në aktivitetet ceremoniale sipas rregullave të përcaktuara në ceremonialin shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe pas vdekjes shoqërohen me nderime ushtarake.

Neni 11

Medalja e Meritës Civile

1. Medalja e Meritës Civile u jepet shtetasve shqiptarë dhe të huaj për aktet e trimërisë, guximit, sakrificës dhe vetëmohimit të kryer në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Medalja e Meritës Civile përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

- a) Medalja e Artë e Meritës Civile;
- b) Medalja e Argjendtë e Meritës Civile;
- c) Medalja e Bronztë e Meritës Civile.

3. Medalja e Meritës Civile mund të jepet më shumë se 1 (një) herë për të njëjtën shkallë.

4. Mbajtësit e shkallës së Medaljes së Artë të Meritës Civile janë pjesë e radhës së përparësisë në aktivitetet ceremoniale sipas rregullave të përcaktuara në ceremonialin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Medalja “Nënë Tereza”

1. Medalja “Nënë Tereza” jepet për merita dhe kontribute të shquara në fushat e bamirësisë, përkujdesjes mjekësore dhe sociale, angazhimit vullnetar në ndihmë të kategorive në nevojë, si dhe në zhvillimin e shoqërisë e vlerave humaniste.

2. Medalja “Nënë Tereza” përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

- a) Medalja e Artë “Nënë Tereza”;

- b) Medalja e Argjendtë “Nënë Tereza”;
- c) Medalja e Bronztë “Nënë Tereza”.
- 3. Medalja “Nënë Tereza” mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën shkallë.
- 4. Mbajtësit e shkallës së Medaljes së Artë “Nënë Tereza” janë pjesë e radhës së përparësisë në aktivitetet ceremoniale sipas rregullave të përcaktuara në ceremonialin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Medalja “Pishtar i Demokracisë”

- 1. Medalja “Pishtar i Demokracisë” u jepet shtetasve shqiptarë dhe të huaj si shenjë përkujtimi për përndjekjen e drejtpërdrejtë në regjimin komunist të kryer mbi baza bindjeje politike apo fetare gjatë periudhës 29.11.1944–31.4.1991.
- 2. Medalja “Pishtar i Demokracisë” përbëhet nga një shkallë dhe jepet edhe pas vdekjes.

Neni 14

Medalja e Mirënjohjes Publike

- 1. Medalja e Mirënjohjes Publike jepet për të vlerësuar kontribute të shquara në shërbim të shtetit shqiptar dhe të forcimit të shoqërisë demokratike brenda dhe jashtë vendit.
- 2. Medalja e Mirënjohjes Publike përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:
 - a) Medalja e Artë e Mirënjohjes Publike;
 - b) Medalja e Argjendtë e Mirënjohjes Publike;
 - c) Medalja e Bronztë e Mirënjohjes Publike.
- 3. Medalja e Mirënjohjes Publike jepet vetëm një herë për secilën shkallë.
- 4. Shkalla më e ulët e medaljes nuk mund të jepet nëse është dhënë më parë një shkallë më e lartë.
- 5. Mbajtësit e shkallës së Medaljes së Artë të Mirënjohjes Publike janë pjesë e radhës së përparësisë në aktivitetet ceremoniale, sipas rregullave të përcaktuara në ceremonialin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Medaljet përkujtimore ushtarake dhe civile

- 1. Medaljet përkujtimore ushtarake dhe civile u jepen, sipas rastit, subjekteve që kanë marrë pjesë në:
 - a) ngjarje të rëndësishme ushtarake dhe civile;
 - b) operacione/misione ushtarake;
 - c) operacione për menaxhimin e situatave të krijuara nga rastet e fatkeqësive natyrore ose emergjencave civile;
 - ç) ngjarje të tjera të ngjashme me rastet e mësipërme sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës propozues.
- 2. Medaljet përkujtimore ushtarake dhe civile krijohen jo më vonë se 1 (një) vit nga zhvillimi i ngjarjes dhe shpërndahen deri në 3 (tre) vjet nga përfundimi i saj.
- 3. Medaljet përkujtimore përbëhen nga një shkallë.
- 4. Medaljet përkujtimore krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për fushën përkatëse.
- 5. Kriteret për dhënien e medaljeve përkujtimore ushtarake dhe civile përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Medalja e Shërbimit Ushtarak

1. Medalja e Shërbimit Ushtarak u jepet personave që janë pjesë e personelit ushtarak dhe civil në Forcat e Armatosura për njohjen e përkushtimit dhe kontributit në shërbim të interesave kombëtarë dhe kryerjen me përgjegjësi të lartë të detyrave.

2. Kjo medalje u jepet edhe ushtarakëve të huaj për merita dhe kontribut të veçantë për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Medalja e Shërbimit Ushtarak përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

a) Medalja e Artë e Shërbimit Ushtarak;

b) Medalja e Argjendtë e Shërbimit Ushtarak;

c) Medalja e Bronztë e Shërbimit Ushtarak.

4. Kriteret për dhënien e Medaljes së Shërbimit Ushtarak përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Medalja e Shërbimit të Rendit Publik

1. Medalja e Shërbimit të Rendit Publik u jepet shtetasve shqiptarë dhe të huaj si shenjë nderimi për kontributin e dhënë në luftën kundër krimit, për mbrojtjen e jetës, rendit dhe qetësisë publike, ruajtjen dhe administrimin e pronës, kontrollin e situatave të jashtëzakonshme, si dhe për ushtrimin me kurajë dhe guxim të përgjegjësive dhe detyrave, që parashikohen në legjislacionin që rregullon rendin e sigurinë publike.

2. Medalja e Shërbimit të Rendit Publik përbëhet, në rend zbritës, nga këto shkallë:

a) Medalja e Artë e Shërbimit të Rendit Publik;

b) Medalja e Argjendtë e Shërbimit të Rendit Publik;

c) Medalja e Bronztë e Shërbimit të Rendit Publik.

3. Kriteret për dhënien e Medaljes së Shërbimit të Rendit Publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 18

Shenjat dhe distinktivët e nderit

1. Për të vlerësuar shërbimin, punën dhe aftësimin profesional në Forcat e Armatosura, mund të krijohen medalje, shenja dhe distinktivë të veçantë nderi për mirënjohje, përkujtime apo shërbimi, të cilat jepen me urdhër të ministrit përgjegjës për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose të autoriteteve të tjera përgjegjëse ushtarake.

2. Krijimi i medaljeve, shenjave dhe distinktivëve të veçantë të nderit, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Specifikimet teknike të urdhrave dhe medaljeve

Përshkrimet e specifikimet teknike të urdhrave dhe medaljeve, si dhe të certifikatave dhe letrave noftuese për dorëzimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III DHËNIA E DEKORATAVE

Neni 20

Rregulla të përgjithshme për dhënien e dekoratave

1. Dekorimi në njërin prej urdhrave, si rregull, fillon nga shkalla më e ulët e urdhrit. Subjekteve mund t'u jepet çdo shkallë e një urdhri, duke u bazuar në rëndësinë e meritave dhe të kontributeve të tij. Subjektet mund të marrin një shkallë më të lartë të një urdhri vetëm për shkak të një merite të re dhe kontributi të posaçëm të ndryshëm nga ai që ka motivuar dekorimin fillestar. Mbajtësit e dekoratës së një urdhri, të cilët marrin një shkallë më të lartë të dekoratës, e zëvendësojnë dekoratën e shkallës më të ulët me atë të shkallës më të lartë që u është dorëzuar.

2. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe, dekorimi me njërin prej medaljeve mund të fillojë nga cilado shkallë dhe mund të kryhet më shumë se një herë për të njëjtën shkallë, në varësi të aktit të kryer.

3. Dekorimi në njërin prej urdhrave, që parashikohen në këtë ligj, si rregull, bëhet vetëm kur subjekti është gjallë. Përjashtimisht, dekorimi në njërin prej urdhrave mund të bëhet edhe menjëherë pas vdekjes.

4. Medalja e Meritës Ushtarake dhe Medalja e Meritës Civile, si rregull, jepen vetëm kur subjekti është gjallë. Përjashtimisht, Medalja e Meritës Ushtarake dhe Medalja e Meritës Civile mund të jepen edhe menjëherë pas vdekjes vetëm për akte të jashtëzakonshme trimërie, guximi, vetëmohimi dhe sakrifice në interesin e përgjithshëm të shoqërisë, që kanë shkaktuar humbjen e jetës së personit.

5. Në rast se dekorohet një person juridik ose një subjekt tjetër i parashikuar në nenin 4 të këtij ligji, dekorimi në njërin prej urdhrave ose me medalje mund të bëhet vetëm kur personi juridik ose subjekti nuk ka mbaruar ose nuk ka pushuar veprimtarinë e tij.

6. Kur dekorimi bëhet për merita apo akte në kohë lufte ose gjatë veprimeve luftarake ose kur akti i kryer ka sjellë plagosjen e personit apo humbjen e jetës së tij, jepet dekoratë e zbukuruar me shpata.

7. Deputetët dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave nuk mund të dekorohen me një prej urdhrave gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

Neni 21

Dekorimi i personaliteteve të huaja për shkak të funksionit

1. Presidenti i Republikës dhe Kryeministri mund të dekorojnë personalitete të huaja për shkak të funksionit mbi bazën e zakoneve dhe traditës diplomatike, si dhe të reciprocitetit ndërkombëtar pas konsultimit me ministrin përgjegjës për punët e jashtme.

2. Dekorimi i personaliteteve të huaja për shkak të funksionit i njoftohet Kancelarisë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e dhënies së dekoratës, me qëllim regjistrimin në regjistrin e personave të dekoruar.

Neni 22

Numri vjetor i dekorimeve

1. Numri vjetor i dekoratave që mund të jepen për secilën shkallë nuk mund të jetë më i madh se:

- a) për Urdhrin Suprem të Shqiponjës:
 - i. Ylli i Madh - 2 (dy);
 - ii. Oficer i Madh - 3 (tre);
 - iii. Komandar - 5 (pesë);
 - iv. Oficer - 10 (dhjetë);

- v. Kalorës – 20 (njëzet);
- b) për Urdhrin e Skënderbeut:
 - i. Ylli i Madh - 3 (tre);
 - ii. Oficer i Madh - 6 (gjashtë);
 - iii. Komandar - 20 (njëzet);
 - iv. Oficer - 40 (dyzet);
 - v. Kalorës - 50 (pesëdhjetë);
- c) për Urdhrin e Lisit Akademik:
 - i. Ylli i Madh - 5 (pesë);
 - ii. Komandar - 10 (dhjetë);
 - iii. Kalorës - 80 (tetëdhjetë).

2. Presidenti i Republikës, në cilësinë e kryetarit të urdhrin, mund të dekorojë kryesisht çdo vit, pa propozim paraprak të autoriteteve përkatëse, deri në 10% të secilës shkallë, sipas parashikimit të pikës 1 të këtij neni.

3. Dekorimet e shtetasve të huaj për shkak të funksionit dhe dekorimet kryesisht, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk përfshihen në numrin vjetor të dekoratave që mund të jepen sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni. Në çdo rast, dekorimet kryesisht i njoftohen Kancelarisë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e dhënies së dekoratës.

4. Numri vjetor i medaljeve është i pakufizuar.

Neni 23

Heqja e dekoratave

Heqja e dekoratave bëhet:

- a) me vendim të formës së prerë të dhënë nga gjykatat shqiptare, kur është dhënë si dënim plotësues, sipas përcaktimeve në Kodin Penal;
- b) me vendim të autoritetit përgjegjës për dhënie të dekoratës, kur mbajtësi i saj:
 - i. është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale; ose
 - ii. është shpallur “person i padëshiruar” sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt në Republikën e Shqipërisë.

KREU IV

KANCELARIA E URDRHAVE DHE MEDALJEVE

Neni 24

Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve

1. Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të rregullores së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të legjislacionit në fuqi.

2. Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Neni 25

Funksionet e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve

Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) vlerëson përmbushjen e kriterëve formale të propozimit për dekorim të përcjella nga autoritetet përkatëse;
- b) kërkon plotësimin e dosjes nga autoriteti propozues, nëse propozimi nuk është i plotë;
- c) shqyrton dosjet e kandidaturave për dekorim, të përcjella nga autoritetet përkatëse;

- ç) me kërkesën e organeve përgjegjëse, jep mendim për:
 - i. dekorimet e shtetasve të huaj;
 - ii. dekorimet e shtetasve shqiptarë nga shtete të tjera;
 - iii. mbajtjen publike nga shtetas shqiptarë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të dekoratave të huaja; dhe
 - iv) reciprocitetin e shkëmbimit të dekoratave për arsye ceremoniale;
 - v) çdo detyrë e ngarkuar nga Kolegji;
- d) përgatit raportet vjetore për gjendjen e dekoratave në Republikën e Shqipërisë;
- dh) mban regjistrat dhe arkivat në lidhje me personat e dekoruar, si dhe propozimet e marra nga institucionet përgjegjëse;
- e) kujdeset për ruajtjen e trashëgimisë dhe të kujtesës materiale të dekoratave dhe mbajtësve të tyre;
- ë) mbikëqyr konceptimin, prodhimin dhe përputhshmërinë e dekoratave me specifikimet përkatëse, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- f) mbikëqyr përgatitjen e certifikatave dhe letrave njoftuese për dorëzimin e dekoratave, me specifikimet përkatëse, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- g) ushtron çdo detyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe rregullorja e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve.

Neni 26

Organizimi i Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve

1. Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve organizohet në nivel qendror.
2. Organet drejtuese të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve janë Kancelari dhe Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve.
3. Struktura dhe organika e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve miratohet me urdhër të Kryeministrit sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
4. Rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve përcaktohen në Rregulloren e Kancelarisë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit.
5. Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve ka logon, stemën dhe shenjat dalluese të saj, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve

1. Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, si më poshtë:
 - a) Kancelari;
 - b) 1 (një) përfaqësues i emëruar nga Presidenti i Republikës;
 - c) Drejtuesi i Protokollit të Shtetit;
 - ç) 1 (një) përfaqësues i emëruar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;
 - d) 2 (dy) ekspertë të fushës së dekorimeve, të emëruar me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - dh) 3 (tre) Dekanët e Urdhrave, të cilët janë shtetasit shqiptarë më të vjetër në moshë, të dekoruar me “Yllin e Madh” në secilin prej urdhrave.
2. Anëtarët e përcaktuar në shkronjat “b”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni emërohen për 4 (katër) vjet, me të drejtë riemërimi.
3. Kryetari i Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve është Kancelari dhe zëvendëskryetar është përfaqësuesi i emëruar nga Presidenti i Republikës.
4. Këshilli i Ministrave përcakton masën e shpërblimit për veprimtarinë e anëtarëve.

Neni 28
Mbarimi i mandatit

1. Mandati i anëtarit të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve mbaron kur:
 - a) përfundon mandatin 4-vjeçar, në rastin e anëtarëve të përcaktuar në shkronjat “b”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) shkarkohet sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni;
 - ç) largohet nga funksioni në rastin e anëtarëve të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji;
 - d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;
 - dh) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
2. Anëtarët e përcaktuar në shkronjat “b”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji mund të shkarkohen nga organi i emërtesës në rast se mungojnë brenda një viti më shumë se një të tretën e mbledhjeve ose në mënyrë të përsëritur, për jo më pak se dy mbledhje të njëpasnjëshme, pengojnë formimin e kuorumit për mbajtjen e një mbledhjeje të vlefshme të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve.
3. Në rast se mbaron mandati i Dekanit të Urdhrit, sipas shkaqeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Presidenti i Republikës, në cilësinë e kryetarit të urdhrit, cakton si anëtar të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve anëtarin tjetër të urdhrit, me moshën më të madhe, që është dekoruar me “Yllin e Madh të Urdhrit”.
4. Mbarimi i mandatit të anëtarit të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve deklarohet me vendim të organit të emërtesës ose në rastin e anëtarëve *ex officio* me vendim të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve.

Neni 29
Detyrat e Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve

- Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve kryen këto detyra:
- a) verifikon meritat dhe cilësitë morale të subjekteve të propozuara për dekorim në Republikën e Shqipërisë;
 - b) shqyrton dosjet e kandidaturave për dekorim, të përcjella nga autoritetet propozuese përkatëse;
 - c) jep mendim të arsyetuar për ligjshmërinë e dobishmërinë e dekorimit dhe njofton autoritetet përkatëse;
 - ç) mbikëqyr hartimin e raporteve nga punonjësit e Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve;
 - d) mbikëqyr mbajtjen e regjistrave dhe arkivave në lidhje me personat e dekoruar;
 - dh) nxjerr udhëzime për mbajtjen publike të dekoratave të huaja nga shtetasit shqiptarë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 30
Kancelari

1. Kancelaria drejtohet nga Kancelari.
2. Kancelari emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit.
3. Kancelari duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të ketë diplomë të arsimit të lartë, së paku në nivelin “Master i shkencave”, ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
 - ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në administratën publike;

- d) të dallohet për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etike dhe morale;
 - dh) të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.
 - ë) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit për të drejtën e informimit për dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
 - f) të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.
4. Marrëdhëniet e punës së Kancelarit dhe të punonjësve të Kancelarisë rregullohen në bazë të Kodit të Punës.
5. Kancelari është mbajtes i shkallës “Komandar i Urdhrit Suprem të Shqiponjës” që prej ditës kur emërohet në detyrë.
6. Kancelari nuk mund të jetë i punësuar me kohë të plotë në detyrë tjetër dhe u nënshtrohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesave.

Neni 31

Detyrat e Kancelarit

Kancelari ushtron këto detyra:

- a) përfaqëson Kancelarinë në marrëdhëniet me palët e treta;
- b) menaxhon veprimtarinë e Kancelarisë dhe të punonjësve të saj;
- c) raporton pranë Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit në mënyrë periodike dhe sa herë i kërkohet për veprimtarinë e Kancelarisë;
- ç) përgatit rendin e ditës së mbledhjeve të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve;
- d) kujdeset për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve;
- dh) njofton vendimet e Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve pranë autoriteteve përgjegjëse;
- e) përgatit kërkesat e vendit të punës për rekrutimin e punonjësve të Kancelarisë dhe emëron punonjësit në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë;
- ë) nxjerr akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme të detyrueshme për punonjësit e Kancelarisë për realizimin e funksioneve të këtij institucioni;
- f) çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe rregullorja e Kancelarisë.

KREU V

PROCEDURAT E DEKORIMIT

Neni 32

E drejta e propozimit

1. Përveç rasteve të dekorimit kryesisht, të drejtën e propozimit për dhënien e dekoratave e kanë subjektet e mëposhtme:
- a) Kryetari i Kuvendit;
 - b) Kryeministri;
 - c) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
 - ç) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
 - d) Kryetari i Akademisë së Shkencave;
 - dh) rektorët e institucioneve publike të arsimit të lartë;
 - e) krerët e bashkësive fetare të njohura nga ligji; dhe
 - ë) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Propozimi për dhënien e Medaljes së Shërbimit Ushtarak dhe Medaljes së Shërbimit të Rendit Publik bëhet respektivisht nga:

- a) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm;
- b) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3. Çdo shtetas ka të drejtë të paraqesë kërkesën për ushtrimin e së drejtës së propozimit për një shtetas të caktuar në një nga institucionet që e kanë këtë të drejtë, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast kërkesa duhet të arsyetojë edhe shkaqet për të cilat shtetasi kërkon ushtrimin e së drejtës së propozimit. Institucioni pranë të cilit është paraqitur kërkesa, ia përcjell atë Kancelarisë, e cila e shqyrton kërkesën në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe në përfundim vendos për pranimin ose refuzimin e saj.

Neni 33

Propozimi për dekorim

1. Propozimi për dekorim dërgohet pranë Kancelarisë, si rregull, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e dekoratës, me përjashtim të rasteve kur sipas rrethanave të çështjes nuk është e mundur zbatimi i këtij afati.

2. Në aktin e propozimit përcaktohen:

- a) autoriteti propozues;
- b) baza ligjore për propozimin;
- c) lidhja midis autoritetit propozues dhe të propozuarit për dekorim;
- ç) gjeneralitetet dhe veprimtaria publike e personit të propozuar;
- d) arsyet e hollësishme për dekorimin e subjektit;
- dh) lloji dhe shkalla e dekoratës të propozuar;
- e) informacionet që vërtetojnë përmbushjen e kritereve përkatëse për dhënien e dekoratës, sipas përcaktimeve në këtë ligj;
- ë) informacioni se personi i propozuar nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, si dhe që nuk është nën hetim ose gjykim për një vepër penale nga organet përgjegjëse;
- f) të dhënat për dekorime të mëparshme të personit të propozuar;
- g) çdo element tjetër të nevojshëm, që shpreh plotësimin dhe verifikimin e kritereve përkatëse për dekorim të subjektit.

3. Akti i propozimit shoqërohet me dokumentacionin provues, që vërteton plotësimin e kritereve përkatëse për dekorim.

Neni 34

Shqyrtimi i propozimit

1. Kancelaria verifikon nëse akti i propozimit i përmban të gjitha elementet formale të kërkuara nga ky ligj, duke hartuar për këtë qëllim raportin përkatës.

2. Nëse propozimi nuk është i plotë, Kancelaria kërkon me shkrim, si rregull, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së propozimit plotësimin e tij nga autoriteti propozues. Plotësimi i propozimit bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

3. Nëse propozimi është i plotë, Kancelaria njofton Kolegjin, duke i dërguar raportin përkatës për verifikimin e propozimit.

4. Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve shqyrton çështjen dhe përcjell vlerësimin e tij nëpërmjet Kancelarit pranë autoritetit përgjegjës për dhënien e dekoratës brenda një afati të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete, por, në çdo rast, brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative. Kancelari i njofton vlerësimin e Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve edhe autoritetit propozues.

5. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet për shkak të rrethanave të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dekorimit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 35

Vlerësimet e Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve

1. Pas shqyrtimit të dosjes së propozimit për dekorim, Kolegji i Urdhrave dhe Medaljeve jep mendim të arsyetuar për:

- a) miratimin e propozimit; ose
- b) refuzimin e propozimit.

2. Në çdo rast, mendimi i arsyetuar i Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve i njoftohet autoritetit përgjegjës për dhënien e dekoratës dhe autoritetit propozues.

3. Presidenti vendos për dhënien ose mosdhënien e dekoratës, pavarësisht vlerësimit përkatës të Kolegjit.

Neni 36

Ceremonia e dekorimit

1. Dorëzimi i dekoratave bëhet në çdo rast me ceremoni, e cila mund të jetë publike ose jopublike, sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre.

2. Ceremonia e dhënies së dekoratës organizohet nga autoriteti përgjegjës për dhënien e dekoratës, si rregull, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i saj ose në ditët e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni. Për shkaqe të arsyeshme, ceremonia e dhënies së dekoratës mund të bëhet brenda një afati tjetër të arsyeshëm sipas rrethanave të çështjes konkrete.

3. Ceremonia e dekorimit, si rregull, organizohet në ditët festive të urdhrave, në ditët që shënojnë përvjetorë, ngjarje të rëndësishme historike, si dhe në ditët e festave zyrtare kombëtare.

4. Datat festive të urdhrave janë si më poshtë:

- a) data festive e Urdhrit Suprem të Shqiponjës është 28 nëntor;
- b) data festive e Urdhrit të Skënderbeut është 2 mars;
- c) data festive e Urdhrit të Lisit Akademik është 7 mars.

5. Ceremonia e dhënies së dekoratave organizohet nga autoriteti propozues në bashkëpunim me Kancelarinë dhe autoritetin përgjegjës për dhënien e saj ose persona të autorizuar prej tij.

6. Dorëzimi i dekoratës së “Yllit të Madh të Urdhrave”, i Medaljes së Artë të Meritës Ushtarake dhe i Medaljes së Artë të Meritës Civile bëhet personalisht nga Presidenti i Republikës.

7. Dorëzimi i dekoratave të shkallëve të tjera të urdhrave, si dhe i medaljeve bëhet personalisht nga Presidenti i Republikës, ose nga përfaqësues të tij, ose nga një autoritet tjetër i deleguar prej tij. Në ceremoninë e dekorimit marrin pjesë edhe përfaqësues të autoritetit propozues.

8. Rregulla të tjera të hollësishme, që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e ceremonisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 37

Dekoratat e huaja

1. Çdo shtetas shqiptar i dekoruar nga shtete apo entitete të huaja, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të përcjellë pranë Protokollit të Shtetit informacionin e plotë rreth dekoratës së akorduar, përshkrimin e saj fizik dhe kopje të certifikatës shoqëruese.

2. Protokollit i Shtetit raporton për secilin rast pranë Kolegjit të Urdhrave dhe Medaljeve të Kancelarisë.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 38
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 15, pika 5; nenit 16, pika 4; nenit 17, pika 3; nenit 18, pika 2; nenit 19, nenit 26, pika 4 dhe pika 5; nenit 27, pika 1, shkronja “d”, dhe nenit 36, pika 8, të këtij ligji.

Neni 39
Shfuqizime

Ligji nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 9/2015 “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen me ngritjen dhe funksionimin e Kancelarisë sipas këtij ligji.

Neni 40
Dispozita kalimtare

1. Dekoratat e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji njihen dhe mbahen sipas motivacionit e kushteve me të cilat janë dhënë.
2. Heqja e dekoratave bëhet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 41
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.2.2024.

KRYETARE
Lindita Nikolla